



RAPORT

**MBI PJESËMARRJEN
E PUBLIKUT
NË PROCESIN
E VENDIMMARRJES
GJATË VITIT 2015**

HYRJE	2
1. Pjesëmarrja në Komisione	5
2. Pjesëmarrja në Seancë Plenare, Vizita, etj.	21
3. Transparenca Parlamentare	24
4. Gjetje dhe Rekomandime	26

HYRJE

Pjesëmarrja e publikut në vendimmarrjen e Kuvendit është një kompleksitet aktivitetesh, funksioni primar i të cilave është rritja e ndërgjegjësimit për parlamentin si institucion, lehtësimi i shpërndarjes dhe shkëmbimit të informacionit, ideve dhe pikëpamjeve mes qytetarëve dhe organeve të Kuvendit.

Pjesëmarrja e publikut në vendimmarrje është një element i rëndësishëm për çdo sistem politik demokratik, transparent dhe të përgjegjshëm. Ajo siguron vazhdimin e dialogut mes qytetarëve dhe deputetëve edhe jashtë periudhës së fushatave elektorale. Rezultati i pjesëmarrjes së publikut në vendimmarrjen e Kuvendit janë politika dhe legjislacion më i përgjegjshëm në përputhje me nevojat e qytetarëve. Organizatat e shoqërisë civile luajnë një rol të rëndësishëm në këtë pjesëmarrje, pasi ato shërbejnë si një urë lidhëse mes Kuvendit dhe qytetarëve. Pjesëmarrja e publikut është veçanërisht e rëndësishme kur flitet për grupet vulnerabël, zëri i të cilëve shpesh neglizhohet të dëgjohet nga vendimmarrësit.

Pjesëmarrja e shoqërisë civile në hartimin dhe zbatimin e legjislacionit është një element i rëndësishëm i asaj që sot ka filluar të quhet “demokracia pjesëmarrëse”. Kjo formë demokracie nuk zëvendëson demokracinë përfaqësuese, por e plotëson atë dhe e bën funksionale. Në këtë kuptim, pjesëmarrja e shoqërisë civile në procesin e vendimmarrjes së Kuvendit krijon kushtet e nevojshme për qytetarët që të marrin pjesë aktive në jetën politike gjatë gjithë legjislaturës dhe jo vetëm në momentin kur i kërkohet të zgjedhin atë; i krijon mundësinë qytetarëve që të avokojnë për interesat e tyre të ligjshme dhe kështu të kontribuojnë për krijimin e një demokracie të qëndrueshme; detyron institucionin të jetë më transparent dhe afron deputetët më shumë me zgjedhësit; kontribuon në përmirësimin e legjislacionit dhe lehtëson implementimin e tij.

Është e rëndësishme për vetë Kuvendin që të inkurajojë zhvillimin e një shoqërie civile të shëndetshme dhe të përgjegjshme, për vendosjen dhe përparimin e një dialogu të përhershëm dhe jo spontan, mbi baza besimi reciprok mes institucionit dhe qytetarëve. Për këtë arsye, me vendimin nr. 17/2014 të Byrosë u miratua Manuali i Pjesëmarrjes së Publikut në Procesin vendimmarrës të Kuvendit. Ky manual u hartua me mbështetjen e Prezencës së OSBE në Shqipëri dhe iu nënshtrua një procesi të gjerë konsultimi me organizatat e shoqërisë civile. Në këtë manual Kuvendi është angazhuar për hartimin e një raporti vjetor të pjesëmarrjes së shoqërisë civile në procesin ligjvënës.

Ky është raporti i parë vjetor në përmbushje të këtij angazhimi, i cili analizon pjesëmarrjen e publikut në vendimmarrjen e Kuvendit përgjatë vitit 2015. Ai fokusohet në rolin përfaqësues të Kuvendit dhe synon të analizojë sesi i është përgjigjur Kuvendi objektivit për informimin dhe përfshirjen e publikut, llogaridhënien dhe përgjegjshmërinë në shërbim të publikut. Raporti është i ndarë në kapituj. Kapitulli I analizon pjesëmarrjen dhe përfshirjen e shoqërisë civile në veprimtarinë e Komisioneve/nënkomisioneve të përhershme parlamentare dhe ndërveprimin mes tyre. Kapitulli II përmban të dhëna mbi qasjen e publikut pranë Kuvendit të Shqipërisë në punimet e tij në seancë plenare, por edhe në vizita me qëllim informimin dhe njohjen më nga afër të mjediseve ku zhvillohet veprimtaria parlamentare. Kapitulli III i kushtohet në tërësi hapave të hedhura nga Kuvendi i Shqipërisë me qëllim forcimin e transparencës parlamentare dhe në përmblyllje, Kapitulli IV përmban gjetjet dhe rekomandimet për përmirësimin e mëtejshëm të metodologjisë dhe raportimit të pjesëmarrjes së publikut në vendimmarrjen e Kuvendit të Shqipërisë.

Raporti analizon të dhënat e nxjerra nga shërbimet e Kuvendit, të cilat si përshkrim të punës kanë mbështetjen e organeve të Kuvendit dhe deputetëve në përmbushje të funksioneve të tyre. Janë analizuar të dhënat e mbajtura nga Shërbimi i Komisioneve, i cili ka evidentuar nëpërmjet statistikave, pjesëmarrjen e organizatave të shoqërisë civile dhe grupeve të tjera të interesit (palët e interesuara) në mbledhjet e komisioneve/nënkomisioneve të përhershme parlamentare, kontributin e dhënë prej tyre gjatë ushtrimit të funksionit ligjvënës ose atij kontrollues të Kuvendit.

Janë analizuar të dhënat statistikore të mbajtura nga Shërbimi i Marrëdhënieve me Publikun, në lidhje me pjesëmarrjen e publikut në veprimtarinë e Kuvendit, nëpërmjet pjesëmarrjes në seanca plenare, vizita në Kuvend, etj. si dhe të dhënat statistikore të koordinatorit për të drejtën e informimit, në drejtim të informimit të qytetarëve sipas kërkesave të tyre drejtuar Kuvendit.

Veprimtaria e Kuvendit në drejtim të zbatimit të Rregullores së Kuvendit, Manualit të Pjesëmarrjes së Publikut në Procesin Vendimmarrës të Kuvendit dhe Rezolutës “Për njohjen dhe forcimin e rolit të shoqërisë civile në procesin e zhvillimeve demokratike të vendit” (dhjetor 2014), në drejtim të përmirësimit dhe zhvillimit të marrëdhënieve me shoqërinë civile dhe publikut në përgjithësi, është përqendruar në këto drejtime:

- ³/₄ Rritja e pjesëmarrjes dhe përfshirjes së organizatave të shoqërisë civile në seancat dëgjimore të komisioneve të përhershme parlamentare në procesin ligjvënës dhe kontrollues;
- ³/₄ Përmirësimi i vazhdueshëm i performancës së shërbimeve të Kuvendit në marrëdhëniet me organizatat e shoqërisë civile dhe me publikun;
- ³/₄ Edukimi i publikut, kryesisht organizatave dhe të rinjve për rolin, funksionet e Kuvendit dhe procedurat parlamentare;
- ³/₄ Fokusimi në intensifikimin e marrëdhënieve me organizatat që veprojnë në fushën e mbrojtjes së të drejtave të fëmijëve, grave, minoriteteve, personave me aftësi të kufizuara, etj.

Ky raport i përgjigjet interesit të organizatave të shoqërisë civile dhe publikut në tërësi, në lidhje me pjesëmarrjen e tyre në procesin vendimmarrës të Kuvendit gjatë vitit 2015.

Raporti përmban gjetjet nga vëzhgimi i këtij procesi nën këndvështrimin e shërbimeve të Kuvendit. Prezantimi i tij u bë në një tryezë konsultimi me organizata të shoqërisë civile. Rekomandimet janë fryt i këtij bashkëpunimi, janë produkt i pritshmërive të shoqërisë civile nga Kuvendi i Shqipërisë, të dhëna në tryezën e konsultimit. Në këtë raport ato janë vendosur si gurë kilometrikë objektivash që Kuvendi angazhohet të realizojë në të ardhmen.

KAPITULLI I

Pjesëmarrja në Komisionet e përhershme parlamentare (nënkomisione)

Kuvendi i Shqipërisë ka në përbërjen e tij 8 komisione të përhershme parlamentare (neni 19, pika 2 i Rregullores):

Komisioni për Çështjet Ligjore, Administratën Publike dhe të Drejtat e Njeriut.

Komisioni për Integrimin Europian.

Komisioni për Politikën e Jashtme.

Komisioni për Ekonominë dhe Financat.

Komisioni për Veprimtaritë Prodhuese, Tregtinë dhe Mjedisin.

Komisioni për Punën, Çështjet Sociale dhe Shëndetësinë.

Komisioni për Edukimin dhe Mjetet e Informimit Publik.

Në përbërje të komisioneve të përhershme funksionojnë edhe nënkomisionet parlamentare (neni 19, pika 2 i Rregullores).

Në përbërje të Komisionit për Çështjet Ligjore, Administratën Publike dhe të Drejtat e Njeriut funksionojnë:

Nënkomisioni për të Drejtat e Njeriut;

Nënkomisioni për Administratën Publike;

Nënkomisioni për Qeverisjen Vendore;

Në përbërje të Komisionit për Punën, Çështjet Sociale dhe Shëndetësinë funksionon:

Nënkomisioni për Çështjet e të Miturve, Barazinë Gjinore dhe Dhunën në Familje.

Rregullorja e Kuvendit në nenin 36 të saj, përcakton se:

“1. Komisioni mund të organizojë seanca dëgjimore publike me anëtarë të Këshillit të Ministrave, përfaqësues të lartë të institucioneve shtetërore ose publike, ekspertë, përfaqësues të shoqërisë civile, përfaqësues të grupeve të interesit, si dhe grupime të tjera të interesuara. Komisioni është i detyruar të realizojë seancën dëgjimore, sipas përcaktimeve të bëra në këtë nen, në rast se një e treta e të gjithë anëtarëve të Komisionit e kërkon atë në mënyrë të motivuar me shkrim. 1/1. Gjatë procesit legjislativ, Komisioni mund të organizojë seanca dëgjimore publike, sipas përcaktimeve të bëra në pikën 1 të këtij neni. Komisioni nuk mund të përgatisë raportin për seancë plenare pa u realizuar seanca dëgjimore.”

2. Në përgatitjen e seancës dëgjimore publike, kryetari, në bashkëpunim me zëvendëskryetarin dhe sekretarin e Komisionit, i paraqet të ftuarve çështjet për të cilat kërkohet informacion.”

Seanca dëgjimore publike është mekanizimi me anë të cilit çdo komision parlamentar, brenda fushës së vet të përgjegjësisë, merr informacion nga anëtarë të Këshillit të Ministrave, përfaqësues të lartë të institucioneve shtetërore ose publike, ekspertë, përfaqësues të shoqërisë civile, përfaqësues të grupeve të interesit, si dhe grupime të tjera të interesuara. Seancat dëgjimore publike i japin mundësi deputetëve të zgjerojnë mundësinë e marrjes së informacionit, të shmangin njëanshmërinë e përmbajtjes së tij, duke përmirësuar dhe konsoliduar vendimmarrjen në miratimin e legjislacionit.

Seancat dëgjimore publike zhvillohen:

a) për të marrë informacion për çështje që lidhen me kontrollin e zbatimit të legjislacionit në një fushë të caktuar;

b) gjatë procesit të shqyrtimit të një projektligji (gjatë procesit legjislativ).

Le të ndalemi në seancat dëgjimore të zhvilluara në secilin prej Komisioneve të përhershme parlamentare, sipas fushës së tyre të përgjegjësisë, duke pasur si udhërrëfyes kërkesat e Manualit të Pjesëmarrjes së Publikut në Procesin Vendimmarrës të Kuvendit.

Komisioni për Çështjet Ligjore, Administratën Publike dhe të Drejtat e Njeriut ka në fushën e tij të përgjegjësisë: kodet dhe organizimi i pushtetit gjyqësor, administrata publike, administrata e pushtetit gjyqësor, organizimi dhe funksionimi i pushtetit vendor, shërbimet e pavarura në sistemin e drejtësisë dhe të drejtat e njeriut.

Komisioni ka zhvilluar **9 seanca dëgjimore publike për procesin legjislativ**, për konsultimin e këtyre projektligjeve:

1. Seancë dëgjimore për projektligjin “Për disa ndryshime dhe shtesa në ligjin nr. 8652, datë 31.7.2000 “Për organizimin dhe funksionimin e qeverisjes vendore” të ndryshuar, me pjesëmarrjen e përfaqësuesve të Shoqatës së Bashkive të Shqipërisë, Shoqatës së Komunave të Shqipërisë, Shoqatës së Qarqeve të Shqipërisë, Shoqatës së Këshilltarëve të Bashkive, Shoqatës për Autonomi Vendore, Institutit “Co-Plan”, Shoqatës “Partnerët Shqipëri”, Institutit për Politika Publike dhe Private, Institutit të Studimeve Urbane si dhe me koordinatorë dhe ekspertë projekti nga Zyra e Këshillit të Europës në Shqipëri.

2. Seancë dëgjimore për projektligjet e propozuara nga deputetët Armando Subashi dhe Taulant Balla “Për disa shtesa dhe ndryshime në ligjin nr. 10019, datë 29.12.2008 “Kodi Zgjedhor i Republikës së Shqipërisë”, i ndryshuar” me pjesëmarrjen dhe kontributin e përfaqësuesve të Prezencës së OSBE-së në Tiranë, Zyrës së Këshillit të Europës në Shqipëri, Komisionit Qendror të Zgjedhjeve, Institutit Demokratik Kombëtar dhe organizatave jofitimprurëse: “Për Kulturë Demokratike”, “Për Gratë dhe Fëmijët”, “KRIIK Albania Association”, “Womens Democracy Network Shqipëri”, “AWEN-Rrjeti i Fuqizimit të Gruas në Shqipëri”, “Koalicioni për Pjesëmarrjen e Grave dhe të Rinjve në Politikë”, “Rrjeti i Grave për Barazi në Vendimmarrje”.

3. Seancë dëgjimore për projektligjet “Për hapjen e dosjeve të sigurimit të shtetit dhe procesin e lustracionit” dhe projektligjin “Për të drejtën e informimit për dokumentet e ish-sigurimit të shtetit të Republikës Popullore Socialiste të Shqipërisë”, me përfaqësues nga Ministria e Mirëqënies Sociale dhe Rinisë, Avokati i Popullit, Komisioneri për të Drejtën e Informimit dhe Mbrojtjen e të Dhënave Personale, dhe organizatat jofitimprurëse: “Grupi Shqiptar i të Drejtave të Njeriut”, “Qendra Shqiptare për Rehabilitimin e Traumës dhe Torturës”, “Shoqata e ish- të Burgosurve dhe të Përndjekurve Politikë”, “Unioni Mbarëkombëtar i Grave ish-të Përndjekura”, “Unioni Mbarëkombëtar i të Internuarve dhe të Përndjekurve Politikë”, “Shoqata Kombëtare e Trashëgimtarëve të Pushkatuarve Politikë”, “Shoqata Kombëtare e ish -të Burgosurve Politikë”, “Shoqata Kombëtare e Dëbim Internimeve Politike”, “Shoqata Antikomuniste” si dhe përfaqësues të Prezencës së OSBE-së në Shqipëri.

4. Seancë dëgjimore (2 të tilla) për projektligjin “Kodi i Procedurave Administrative të Republikës së Shqipërisë” me ekspertë kombëtarë dhe ndërkombëtarë të EURALIUS, gjyqtarë të Gjykatave Administrative si dhe pedagogë të Fakultetit të Drejtësisë, avokatë dhe ekspertë të SIGMA.

5. Seancë dëgjimore për projektligjet e propozuara nga deputetja Majlinda Bregu “Për disa ndryshime në ligjin nr. 8116, datë 29.3.1996 “Kodi i Procedurës Civile i Republikës së Shqipërisë” të ndryshuar dhe projektligji “Për një shtesë në ligjin nr. 7850, datë 29.7.1994 “Kodi Civil i Republikës së Shqipërisë” të ndryshuar me përfaqësues nga Ministria e Drejtësisë, Unioni i Gjyqtarëve, Avokati i Popullit, Komisioneri për të Drejtën e Informimit dhe Mbrojtjen e të Dhënave Personale, Fondacioni Shoqëria e Hapur për Shqipërinë - SOROS, Unioni i Gazetarëve, Qendra për Zhvillim & Demokraci Institucionale CDDI, pedagogëve të Fakultetit të Drejtësisë,

përfaqësues të Prezencës së OSBE-së në Shqipëri, dhe përfaqësues nga Zyra e Këshillit të Europës në Shqipëri.

6. Seancë dëgjimore për projektligjin “Për vetëqeverisjen vendore” me organizata përfaqësuese të bashkive dhe qarqeve si: “Shoqata për Autonomi Vendore”, “Shoqata e Bashkive të Shqipërisë”; me përfaqësues të organizatave ndërkombëtare dhe donatorë si: USAID, DLDP; si dhe me organizata jofitimprurëse si: “Co-Plan”, “URI”, “Qendra për Informim”, “Qendra Aleanca Gjimore”, “Instituti i Politikave Publike dhe Private” etj.

7. Seancë dëgjimore për projektligjin “Për trajtimin e pronës dhe përfundimin e procesit të kompensimit të pronave” me shoqatat: “Pronësi me drejtësi”, “Shoqata Kombëtare e Pronarëve Legjitimë”, “Bregdeti”, “Krahina Jonë”, “Borshi”, “Dukati”, “Pronarët e Myzeqesë”, Shoqata e të Burgosurve për Integrim me Drejtësi” si dhe me përfaqësues nga Institucioni i Avokatit të Popullit etj.

8. Seancë dëgjimore për projektligjin “Për disa shtesa dhe ndryshime në ligjin nr. 8328, datë 16.4.1998, “Për të drejtat dhe trajtimin e të dënuarve me burgim dhe të të paraburgosurve”, të ndryshuar” me ekspertë nga: Prokuroria e Përgjithshme, Avokati i Popullit dhe Prezenca e OSBE-së në Shqipëri.

Komisioni ka zhvilluar **konsultimet me palët e interesuara**, duke kërkuar mendimin e tyre me shkrim (pa zhvilluar seancat dëgjimore publike) dhe komentet e dërguara prej tyre janë diskutuar më pas në mbledhjet përkatëse.

Kjo mënyrë konsultimi është përdorur për këto projektligje:

1. Projektligji “Për disa ndryshime dhe shtesa në ligjin nr. 7961, datë 12.07.1995 “Kodi i Punës i RSH” të ndryshuar”, i është dërguar për mendim: Avokatit të Popullit, Bashkimit të Sindikatave të Pavarurara të Shqipërisë, UNIFEM, Komisionerit për të Drejtën për Informim dhe Mbrojtjen e të Dhenave Personale, Konfederatës së Sindikatave të Shqipërisë, Komitetit Shqiptar të Helsinkit, CRCA, OSBE, UNICEF, Komisionerit për Mbrojtjen nga Diskriminimi, Fondacionit Shqiptar për të Drejtat e Personave me Aftësi të Kufizuara, Rrjeti i Fuqizimit të Gruas në Shqipëri, Federatës së Sindikatave të Arsimit dhe Shkencës, Koalicionit për Gratë dhe të Rinjtë në Politikë.

2. Projektligji “Për disa ndryshime dhe shtesa në ligjin nr. 7895, datë 27.01.1995 “Kodi Penal i Republikës së Shqipërisë” të ndryshuar” i është dërguar për mendim: Prokurorit të

Përgjithshëm, Avokatit të Popullit, Komitetit Shqiptar të Helsinkit, pedagogëve të Fakultetit të Drejtësisë, UT, përfaqësuesve të shoqatave të biznesit.

3. Projektligji “Për disa ndryshime në ligjin nr. 9062, datë 8.5.2003, “Kodi i Familjes” dhe projektligji “Për disa ndryshime dhe shtesa në ligjin nr. 9695, datë 19.3.2007 “Për procedurat e birësimit dhe Komitetin Shqiptar të Birësimit”, të ndryshuar i është dërguar për mendim: UNICEF, Avokatit të Popullit, CRCA, Komitetit Shqiptar të Helsinkit, Klinikës Ligjore për të Mitur, Save the children, Terre des Hommes Albania, World Vision, dhe pedagogëve të Fakultetit të Drejtësisë së UT, etj,

4. Projektligj “Për lejimin e hetimit të pavarur ndërkombëtar mbi akuzat publike të ngritura mbi çështjen “CEZ SHPERNDARJE SH.A.” i është dërguar për mendim: Ministrit të Shtetit për Marrëdhëniet me Parlamentin, OSBE, Ministrisë së Drejtësisë, Ministrit për Çështjet Vendore, EURALIUS, OPDAT, PAMECA, KSHH, ekspertëve të nivelit të lartë të KP “Për Reformën në Sistemin e Drejtësisë”.

5. Projektligji “Për disa shtesa dhe ndryshime në ligjin nr. 8328, datë 16.4.1998, “Për të drejtat dhe trajtimin e të dënuarve me burgim dhe të të paraburgosurve”, të ndryshuar i është dërguar për mendim: OSBE, Prokurorit të Përgjithshëm, Ministrisë së Drejtësisë, Avokatit të Popullit, Komitetit Shqiptar të Helsinkit, CRCA, UNICEF, organizatës “Përthyerja”.

Vërejtjet dhe rekomandimet e palëve të interesuara janë përfshirë në mënyrë të konsiderueshme në përmirësimin e përmbajtjes së neneve të projektligjeve dhe janë pasqyruar në raportet e komisionit për çdo projektligj, drejtuar seancës plenare.

Komisioni për Integrimin European me fushë përgjegjësie: çështjet e integritit europian, përafrimi i legjislacionit me *acquis* e Bashkimit European, mbikëqyrja e zbatimit të angazhimeve që rrjedhin nga Marrëveshja e Stabilizim-Asociimit, si dhe mbikëqyrja e asistencës financiare të Bashkimit European për Shqipërinë.

Komisioni për Integrimin European ka zhvilluar **një seancë dëgjimore publike për procesin legjislativ** për konsultimin e projektligjit “Për rolin e Kuvendit në procesin e Integritit të Republikës së Shqipërisë në Bashkimin European”.

Komisioni për Politikën e Jashtme me fushë përgjegjësie: politika e jashtme, marrëdhëniet dhe bashkëpunimi ndërkombëtar, si dhe zbatimi i marrëveshjeve ndërkombëtare.

Komisioni për Politikën e Jashtme gjatë vitit 2015 **ka zhvilluar një seancë dëgjimore publike për procesin legjislativ**, për konsultimin e projektligjit:

1. Seancë dëgjimore për projektligjin “Për Shërbimin e Jashtëm në Republikën e Shqipërisë” me pjesëmarrjen e grupeve të interesit në fushën e diplomacisë.

Vërejtjet dhe rekomandimet e palëve të interesuara kanë qenë për çështje të veçanta të projektligjit si për procedurën e emërimit të Kreut të Misionit Diplomatik, për kriteret e pranimit në Shërbimin e Jashtëm të personave jashtë këtij shërbimi, etj. Këto vërejtje dhe rekomandime janë përfshirë në mënyrë të konsiderueshme në përmirësimin e përmbajtjes së neneve të projektligjit dhe janë pasqyruar në raportin e komisionit drejtuar seancës plenare.

Komisioni për Ekonominë dhe Financat me fushë përgjegjësie: politikat ekonomike, Buxheti i Shtetit dhe mbikëqyrja e zbatimit të tij, financat publike, privatizimet dhe sistemi bankar.

Komisioni për Ekonominë dhe Financat **ka zhvilluar 3 seanca dëgjimore për procesin legjislativ**, për konsultimin e këtyre projektligjeve:

1. Seancë dëgjimore për projektligjin “Për buxhetin e vitit 2016”, me pjesëmarrjen e palëve të interesuara: Shoqata e Bashkive. Rekomandimet dhe vërejtjet e palëve të interesuara kanë të bëjnë me përmirësimin e formulës për ndarjen e transfertës së pakushtëzuar midis njësive të qeverisjes vendore. Palët e interesuara kanë propozuar 3 amendamente, nga të cilat 2 janë pasqyruar në raportin e komisionit drejtuar seancës plenare.

2. Seancë dëgjimore për projektligjet financiare që shoqërojnë buxhetin e shtetit, me pjesëmarrjen e palëve të interesuara: Shoqata “Biznes Albania”, Shoqata e Bashkive, Shoqata Shqiptare e Turizmit, Shoqata e Prodhuesve të Bukës, Dhoma e Tregtisë dhe Industrisë Tiranë, Dhoma Amerikane e Tregtisë. Rekomandimet dhe vërejtjet e palëve të interesuara kanë të bëjnë me reflektimin e efektit të heqjes apo reduktimit të tatimit të thjeshtuar mbi fitimin e biznesit të vogël, në të ardhurat e njësive të qeverisjes vendore; mosmiratimin e rritjes së akcizës së birrës, duke ruajtur të pandryshuar nivelin e saj; rishikimin e taksës së ndikimit në infrastrukturë, në përputhje me politikat e pushtetit vendor për zhvillimin e zonave të caktuara të qytetit; heqjen e taksës për zënien e hapësirave publike dhe klasifikimin e saj si tarifë, etj. Palët e interesuara kanë propozuar 15 amendamente, nga të cilët 7 janë pasqyruar në raportin e komisionit drejtuar seancës plenare.

3. Seancë dëgjimore për projektligjin “Për lojërat e fatit në Republikën e Shqipërisë” me pjesëmarrjen e palëve të interesuara: Shoqëria “Bingo Tradicionale”, Shoqata e Organizatorëve të Basteve Sportive dhe Shoqëria “Kazinotë elektronike”. Rekomandimet dhe vërejtjet e palëve

të interesuara kanë të bëjnë me: rregullimin e dispozitës tranzitore në të cilën parashikohej që pagesa që kompanitë e basteve sportive duhet të derdhin tek AMFL-ja të ndryshohet nga 3 për qind në 0.5 për qind të xhiros vjetore; heqjen e detyrimit që pikat e basteve sportive të kenë një largësi të paktën 200 metra në vijë ajrore në të gjitha drejtimet, ndërmjet subjekteve të lojërave të fatit dhe nga institucionet, siç janë institucionet fetare, institucionet e arsimit parauniversitar dhe ato të arsimit të lartë; heqjen e tatimit të fitimit për lojtarin nga të ardhurat për lojërat e fatit; etj. Palët e interesuara kanë propozuar 17 amendamente, nga të cilat 7 janë pasqyruar në raportin e komisionit drejtuar seancës plenare.

Komisioni për Sigurinë Kombëtare me fushë përgjegjësie: organizimi i mbrojtjes kombëtare dhe Forcat e Armatosura, bashkëpunimi ushtarak, punët e brendshme, emergjencat civile, rendi publik dhe shërbimet sekrete. Komisioni për Sigurinë Kombëtare ka zhvilluar **5 seanca dëgjimore publike për kontrollin e zbatimit të legjislacionit**. Palët e interesuara që kanë marrë pjesë në mbledhje të komisionit kanë qenë përfaqësues nga Instituti për Demokraci dhe Ndërmjetësim (IDM), përfaqësues nga Instituti i Studimeve të Inteligjencës dhe Sigurisë.

Komisioni për Veprimtaritë Prodhuese, Tregtinë dhe Mjedisin me fushë përgjegjësie: bujqësia, industria, telekomunikacionet, turizmi, rregullimi i territorit, tregtia dhe mbrojtja e mjedisit.

Komisioni për Veprimtaritë Prodhuese, Tregtinë dhe Mjedisin **ka zhvilluar 13 seanca dëgjimore publike për procesin legjislativ** për konsultimin e projektligjeve:

1. Seancë dëgjimore (5 të tilla) për projektligjin “Për sektorin e energjisë elektrike” me pjesëmarrjen e palëve të interesuara: AREA (Shoqata Shqiptare për Energjitë e Rinovueshme), Balfin Group, AAES (Shoqata Shqiptare e Furnizuesve të Energjisë), Konfindustria, FIAA (Shoqata Shqiptare e Investitorëve të Huaj), pedagogë nga Fakulteti i Inxhinierisë Elektrike, përfaqësues të Sekretariatit të Komunitetit të Energjisë në Vjenë, si dhe me përfaqësues të ERE, Autoriteti i Konkurrencës (17), KESH, OST, OSHEE, AKBN. Rekomandimet dhe vërejtjet e palëve të interesuara kanë të bëjnë me kushtet që favorizojnë prodhuesit e energjisë që shfrytëzojnë burimet e rinovueshme; humbjet e shkaktuara gjatë transmetimit dhe shpërndarjes të energjisë, pronësinë e sistemit të transmetimit, roli dhe përgjegjësitë e institucioneve shtetërore, favorizimi i shtresave në nevojë, etj. Palët e interesuara kanë propozuar 26 amendamente nga të cilat 13 janë pasqyruar në raportin e komisionit drejtuar seancës plenare.

2. Seancë dëgjimore për projektligjin “Për sistemin e depozitës për menaxhimin e mbetjeve në Republikën e Shqipërisë” me pjesëmarrjen e palëve të interesuara: Biznes Albania, Shoqata e Ricikluesve, Shoqata e Ushqim Pijeve, Shoqata e Konvertuesve të Plastikës. Rekomandimet dhe vërejtjet e palëve të interesuara kanë të bëjnë me mbledhjen e diferencuar të mbetjeve të ngurta dhe rolin e shtetit në këtë fushë, nevojën e këtij rregullimi në kushtet e vendit tonë, kostot e depozitimit të mbetjeve të ngurta, etj. Palët e interesuara kanë propozuar 16 amendamente. Projektligji gjatë vitit 2015 ka qenë ende në shqyrtim në Komision.

3. Seancë dëgjimore (2 të tilla) për projektligjin “Për turizmin” me pjesëmarrjen e palëve të interesuara: NAT GA (National Association of Tourism), ATA (Shoqata Shqiptare e Turizmit), UOTSH (Unioni i Operatorëve Turistikë Shqiptarë), GIZ Albania, Federata e Rafting Albania. Rekomandimet dhe vërejtjet e palëve të interesuara kanë të bëjnë me strukturimin e tregut të turizmit, vendosja e standardeve në shërbimin e hotelierisë, inspektimin, etj. Palët e interesuara propozuan rreth 132 amendamente, të cilat nuk u pasqyruan në raportin e komisionit drejtuar seancës plenare.

4. Seancë dëgjimore për projektligjin “Për sektorin e gazit natyror” me pjesëmarrjen e palës të interesuar TAP AG, Albpetrol, ERE dhe Autoriteti i Konkurrencës. Disa nga amendamentet e propozuara prej tyre janë pasqyruar në raportin e komisionit drejtuar seancës plenare.

5. Seancë dëgjimore (2 të tilla) për projektligjin “Për eficiencyn e energjisë” (komente/sugjerime nga të cilat janë konsideruar 5) me pjesëmarrjen e palëve të interesuara: ASP (Akademia e Studimeve Politike), GIZ Albania, UNDP, Shoqata e arkitektëve, Instituti i Politikave Mjedisore, ERE, Autoriteti i Konkurrencës, KESH, OST, OSHEE, AKBN. Rekomandimet dhe vërejtjet e palëve të interesuara kanë të bëjnë me Fondin Kombëtar për Eficiencyn e Energjisë, përfshirjen e pushtetit vendor, eficiencyn e energjisë në sektorin industrial, etj. Palët e interesuara kanë propozuar 14 amendamente, nga të cilat 5 janë pasqyruar në raportin e komisionit drejtuar seancës plenare.

6. Seancë dëgjimore për projektligjin “Për Qendrën Kombëtare të Biznesit” me pjesëmarrjen e palëve të interesuara: Unioni i Dhomave të Tregtisë. Pala e interesuar ka propozuar 2 amendamente të cilat nuk janë pasqyruar në raportin e komisionit drejtuar seancës plenare.

Komisioni ka zhvilluar konsultimet me palët e interesuara, duke kërkuar mendimin e tyre me shkrim (pa zhvilluar seancat dëgjimore publike) dhe komentet e dërguara prej tyre janë diskutuar më pas në mbledhjen përkatëse për projektligjin “Për mjekun veterinar”. Projektligji i është dërguar për mendim pedagogëve të Universitetit Bujqësor, Kamëz. Rekomandimet dhe vërejtjet e palëve të interesuara kanë bëjnë me profesionistët që do të anëtarësohen në urdhër, me organet e urdhrit, etj. Palët e interesuara kanë propozuar 12 amendamente, të cilat janë pasqyruar në raportin e komisionit drejtuar seancës plenare.

Komisioni për Punën, Çështjet Sociale dhe Shëndetësinë me fushë përgjegjësie: marrëdhëniet e punës, çështjet sociale, sigurimet shoqërore, familja, gruaja dhe shëndetësia.

Komisioni për Punën, Çështjet Sociale dhe Shëndetësinë **ka zhvilluar 3 seanca dëgjimore për kontrollin e zbatimit të legjislacionit.**

1. Seancë dëgjimore për zbatimin e legjislacionit gjatë procesit të konkurrimit për specializimet në mjekësi me pjesëmarrjen e studentëve konkurrues dhe Ministrit të Shëndetësisë dhe Ministrit të Arsimit. Në këtë seancë u trajtua mundësia për rishpërndarjen e kuotave të trojeve dhe mundësia për bërjen e shtesave për studentë–mjekë që kanë fituar mbi 800 pikë në provimin e shtetit. Komisioni ka përcjellë rekomandime me shkresa zyrtare drejtuar Ministrisë së Arsimit dhe Ministrisë së Shëndetësisë.

2. Seancë dëgjimore me grupet e interesit për zbatimin e legjislacionit të punës dhe kontratave të punës pas deklaratës së dhënë nga Ministri i Shëndetësisë në lidhje me testimin e mjekëve në të gjithë vendin, me pjesëmarrjen e Urdhrit të Mjekëve të Shqipërisë. Në këtë seancë u trajtua konstatimi dhe evidentimi i mangësive dhe i dobësive në kompetencën dhe performancën e mjekëve, dhe i nevojave ku duhet të synojë Edukimi Vazhdueshëm Mjekësor. Njëkohësisht u trajtua dhe kontrolli i mjekëve sipas legjislacionit në fuqi dhe jo sipas nismave spontane dhe të pastuduara.

3. Nënkomisioni për Çështjet e të Miturve, Barazisë Gjinore dhe Dhunës në Familje ka zhvilluar 1 seancë dëgjimore për diskutimin e hapave konkretë për reduktimin e dhunës me bazë gjinore me pjesëmarrjen e organizatave që veprojnë në këtë fushë dhe përfaqësues të ministrive të linjës. Në këtë seancë u trajtuan çështje të tilla si: ngritja e shërbimeve të përkujdesit shëndetësor dhe të rehabilitimit për viktimat e dhunës në marrëdhëniet familjare nga njësitë e qeverisjes vendore me të ardhurat e tyre; zbatimi i rezolutës së Kuvendit të Shqipërisë, datë

2.12.2010 “Për luftën kundër dhunës ndaj gruas dhe rritjen e dimensionit parlamentar të luftës

kundër dhunës në familje”; bashkëpunimi dhe shkëmbimi i ndërsjellë i informacionit me të gjithë aktorët dhe faktorët e shoqërisë për të reduktuar fenomenin.

Komisioni për Punën, Çështjet Sociale dhe Shëndetësinë **ka zhvilluar 12 seanca dëgjimore publike për procesin legjislativ** për konsultimin e projektligjeve:

1. Seancë dëgjimore me grupet e interesit për projektligjin “Për hapjen e dosjeve të sigurimit të shtetit dhe procesin e lustracionit” (nismë e deputetëve Mesila Doda, Shpëtim Idrizi) Palët e interesuara u paraqitën në komision në cilësinë e mbështetësve të projektligjit, i cili u rrëzua në parim nga komisioni.

2. Seancë dëgjimore me grupet e interesit projektligjin “Për disa shtesa dhe ndryshime në Kodin Zgjedhor të Republikës së Shqipërisë” (*iniciativë e deputeteve Mesila Doda, Mimoza Hafizi, Silva Caka*) me pjesëmarrjen e përfaqësuesve të institucionit të Avokatit të Popullit, përfaqësues nga Komisioni Qendror i Zgjedhjeve, përfaqësues nga Komisioneri për Mbrojtjen nga Diskriminimi, përfaqësues nga Prezenca e OSBE-së në Shqipëri. Rekomandimet e palëve të interesuara kanë të bëjnë me garantimin e barazisë gjinore, 50% në mënyrë të plotë në përbërjen e Kuvendit të Republikës së Shqipërisë, ku 70 deputetë të jenë gra, në këshillat bashkiakë 50% të jenë gra, duke krijuar kështu akses të barabartë midis të gjinive. Komisioni e miratoi projektligjin pa ndryshime.

3. Seancë dëgjimore për projektligjin “Për disa shtesa dhe ndryshime në ligjin nr. 10.107, datë 30.03.2009 “Për kujdesin shëndetësor në RSH” të ndryshuar” me pjesëmarrjen e përfaqësuesve nga Urdhri i Mjekut, Urdhri i Infermierit, Urdhri i Farmacistit, përfaqësues nga Urdhri i Stomatologut. Rekomandimet dhe vërejtjet e palëve të interesuara kanë të bëjnë me domosdoshmëria e një gjithëpërfshirjeje reale e të gjithë faktorëve që lidhen me procesin e edukimit të vazhdueshëm, duke saktësuar angazhimet, detyrimet dhe përgjegjësitë e secilit; Krijimin e një programi real, konkret për edukimin e vazhdueshëm, për të evituar spontanitetin që vërehej, pasi vetëm 70% e krediteve teorike të nevojshme u janë ofruar mjekëve. Janë propozuar 7 amendamente të cilat nuk janë miratuar nga komisioni.

4. Seancë dëgjimore për projektligjin “Për ratifikimin e marrëveshjes së shërbimit këshillimor financiar, ndërmjet Këshillit të Ministrave të Republikës së Shqipërisë, përfaqësuar nga Ministria e Shëndetësisë dhe Korporatës Financiare Ndërkombëtare” me pjesëmarrjen e Shoqatës së Teknikëve të Mjekësisë Laboratorike, Shoqatës së Biokimisë klinike dhe Mjekësisë Laboratorike Shqiptare. Rekomandimet e palëve të interesuara kanë të bëjnë me aplikimin e

partneritetit në pjesën e infrastrukturës për mirëmbajtje dhe informatizim; pjesa e menaxhimit financiar, organizativ dhe atij të burimeve njerëzore të mbetet publike; projekti të shtrihet në shërbimin laboratorëve të QSUT.

5. Seancë dëgjimore me grupet e interesit për projektligjin “Për shërbimet dhe produktet biocide në shëndetin publik me pjesëmarrjen e palëve të interesuara: përfaqësues të subjektit privat “Silvio”, përfaqësues të subjektit privat “Marko Genicco”, përfaqësues të subjektit privat “Arli Internacional”, përfaqësues të subjektit privat “Meldi sh.p.k.”, përfaqësues të subjektit privat “Agrohëlp”, përfaqësues të subjektit privat “Genap sh.p.k.”, përfaqësues të Shoqatës së Infektivologjisë, pedagogë të Fakultetit të Shëndetit Publik UT, përfaqësues të Ministrisë së Shëndetësisë. Rekomandimet e palëve të interesuara kanë të bëjnë me përdorimin dhe vendosjen në treg të produkteve biocide dhe rolin e institucioneve shëndetësore në kontrollin e përdorimit të tyre. Palët e interesuara paraqitën 1 amendament, i cili është pasqyruar në raportin e Komisionit drejtuar seancës plenare.

6. Seancë dëgjimore për projektligjin “Për disa shtesa dhe ndryshime në ligjin nr. 10.139, datë 15.5.2009 “Për pensionet shtetërore suplementare të punonjësve të universiteteve të shkollave të larta, qendrës së studimeve albanologjike, akademisë së shkencave dhe të gjitha institucioneve të tjera kërkimore publike në Republikën e Shqipërisë, të cilët kanë tituj shkencorë” me pjesëmarrjen e palëve të interesuara: Federata e Sindikatave të Arsimit dhe Shkencës të Shqipërisë, Akademia e Shkencave, Qendra e Studimeve Albanologjike, pedagogë nga Universiteti European i Tiranës, pedagogë nga Albanian University, përfaqësues të Ministrisë së Mirëqenies Sociale dhe Rinisë dhe ISSH-së. Rekomandimet dhe vërejtjet e palëve të interesuara kanë të bëjnë me rritjen e kontributeve të sigurimeve shoqërore për punonjësit e Universiteteve në një nivel më të lartë se administrata publike. Palët e interesuara propozuan 2 amendamente nga të cilët 1 u pasqyrua në raportin e komisionit drejtuar seancës plenare.

7. Seancë Dëgjimore për projektligjin “Për një ndryshim në ligjin nr. 104/2015 “Për barnat dhe shërbimet farmaceutike” me pjesëmarrjen e palëve të interesuara: Shoqata Shqiptare e Përfaqësive Farmaceutike, përfaqësuesi i firmës farmaceutike “Krka”, përfaqësuesi i firmës farmaceutike “Berlin Chemie”, Unioni i Biznesit Farmaceutik, Urdhri i Farmacistëve të Shqipërisë, përfaqësuesi i firmës farmaceutike “Trimed sh.p.k.”, Grupimi i Përfaqësuesve të Barnave Gjenerike. Vërejtjet e palëve të interesuara kanë të bëjnë me autorizimin për tregtim të

barnave. Palët e interesuara propozuan 2 amendamente. Komisioni ka miratuar projektligjin pa ndryshime.

8. Seancë dëgjimore për projektligjin “Për disa ndryshime dhe shtesa në ligjin nr. 7961, datë 12.07.1995 “Kodi i Punës i RSH” të ndryshuar” me pjesëmarrjen e palëve të interesuara: Përfaqësues nga Ministria e Mirëqenies Sociale dhe Rinisë, Bashkimit të Sindikatave të Pavarura të Shqipërisë, Federata Sindikale e Arsimit dhe Shkencës, Sindikata e Pavarur e Minatorëve të Shqipërisë, Dhoma e Tregtisë dhe Industrisë, Konfederata e Industrive të Shqipërisë, Dhoma e Fasonëve, përfaqësuese e CLËG-së, përfaqësuese e QNLQ-së, Qendra Aleanca Gjinore për Zhvillim, Universitetin e Tiranës, përfaqësuese e Rrjetit të Grave për Barazi dhe Vendimmarrje. Rekomandimet dhe vërejtje te palëve të interesuara kanë të bëjnë me marrëdhëniet e punës, kohën e punës dhe pushimit, kontratat e punës, mbrojtjen e veçantë të grave dhe fëmijëve në marrëdhëniet e punës, etj. Palët e interesuara propozuan amendamente për 12 nene të projektligjit, nga të cilat 7 komisioni i ka pasqyruar në raportin drejtuar komisionit përgjegjës.

9. Seancë dëgjimore “Për krijimin dhe funksionimin e Këshillit Kombëtar për shoqërinë civile” me pjesëmarrjen e palëve të interesuara: Përfaqësues nga Avokati i Popullit, Komiteti Shqiptar i Helsinkit, Grupit për të drejtat e njeriut, Delegacioni i Bashkimit European në Shqipëri, PAK, UNDP, OSBE, NDI Albania – National Democratic Institute, Open Data, CRCA, PARTNERS Albania, Qendra e Aleancës Gjinore për Zhvillim, Rrjeti i qendrave për zhvillim komunitar “Sot për të ardhmen” , Rrjeti i Fuqizimit të Gruas në Shqipëri – AWEN, Rrjeti i Grave “Barazi në Vendimmarrje”, Rrjeti i grave “Të Ndryshëm & të Barabartë”, “Linja e Këshillimit për Gra e Vajza”, “Qendra Shqiptare për Popullsinë e Zhvillimin”, Shoqata për Integrimin e Zonave Informale, Qendra për Nisma Ligjore Qytetare. Rekomandimet dhe vërejtjet e palëve të interesuara kanë të bëjnë kryesisht me përfaqësimin e organizatave në këtë këshill dhe përbërjen e tij. Palët e interesuara kanë propozuar 12 amendamente nga të cilat 4 janë pasqyruar në raportin e komisionit drejtuar seancës plenare.

10. Seancë dëgjimore për projektligjin “Për disa ndryshime në ligjin nr. 9062, datë 8.5.2003, “Kodi i Familjes” dhe për projektligjin “Për disa ndryshime dhe shtesa në ligjin nr. 9695, datë 19.3.2007, “Për procedurat e birësimit dhe Komitetin Shqiptar të Birësimit”, të ndryshuar” me pjesëmarrjen e palëve të interesuara: Përfaqësues nga Avokati i Popullit, OSAAB, CRCA, Save the Children, Shoqata e Ardhmja Jone, përfaqësues nga Komiteti Shqiptar i birësimit. Rekomandimet dhe vërejtjet e palëve të interesuara kanë të bëjnë me kriteret e

emërimit të kryetarit të Komitetit, kriteret që duhet të plotësojnë prindërit adoptues, etj. Palët e interesuara propozuan 5 amendamente për të dy projektligjet, nga të cilat komisioni ka pasqyruar në raportin për projektligjin për ndryshimet në procedurat e birësimit 1 prej tyre. Projektligji për ndryshimet në Kodin e Familjes është miratuar nga Komisioni pa ndryshime.

11. Seancë dëgjimore me grupet e interesit për projektligjet financiare që shoqërojnë projektligjin për buxhetin e vitit 2015:

Projektligji “Për një shtesë në ligjin nr. 7703, datë 11.5.1993, “Për sigurimet shoqërore në Republikën e Shqipërisë”, të ndryshuar” dhe “Për një ndryshim në ligjin nr. 10383, datë 24.2.2011, “Për sigurimin e detyrueshëm të kujdesit shëndetësor në Republikën e Shqipërisë”, të ndryshuar” me pjesëmarrjen e palëve të interesuara: Dhoma e Avokateve të Shqipërisë; Dhoma e Noterëve të Shqipërisë. Urdhri i Mjekut, Urdhri i Farmacist, Urdhri i Infermierit; Shoqata e Inxhinierëve, Shoqata e Dentistëve të Shqipërisë, Shoqata Shqiptare e Arkitektëve. Vërejtjet e palëve të interesuara kanë të bëjnë me mënyrën dhe masën e llogaritjes së kontributeve të sigurimeve shoqërore të detyrueshme për t’u paguar. Palët e interesuara propozuan 1 amendament. Komisioni i ka miratuar këto projektligje pa ndryshime.

12. Seancë dëgjimore me grupet e interesit për projektligjin “Për buxhetin e vitit 2016” për pjesën e Ministrisë Mirëqenies Sociale dhe Rinisë, si dhe për pjesën e Ministrisë së Shëndetësisë me pjesëmarrjen e palëve të interesuara: Këshilli Kombëtar i Personave me Aftësi Kufizuar; “Lëvizja Rinore Egjiptiane & Rome”; CRCA - Qendra për Mbrojtjen e të Drejtave të Fëmijëve ; Save the Children; Koalicioni Arsimin e Fëmijëve të Shqipërisë; Shoqata e Fëmijëve dhe të rinjve me diabet; Shoqata Shqiptare e Diabetit, Konfederata e Sindikatave të Shqipërisë, Bashkimi i Sindikatave të Pavarura të Shqipërisë. Rekomandimet e grupeve të interesit kanë të bëjnë me alokimin e fondeve për programe të caktuara, me rritjen e pagave, etj. Palët e interesuara propozuan 5 rekomandime, të cilat komisioni ia përcolli Komisionit përgjegjës për Ekonominë dhe Financat.

Komisioni për Edukimin dhe Mjetet e Informimit Publik me fushë përgjegjësie: arsimit në çdo nivel, kultura, rinia, shkenca, sportet, media e shkruar dhe vizive.

Komisioni për Edukimin dhe Mjetet e Informimit Publik **ka zhvilluar 9 seanca dëgjimore për procesin legjislativ** për konsultimin e projektligjeve:

1. Seancë dëgjimore (3 të tilla) për projektligjin “Për disa ndryshime në ligjin nr. 69/2012 “Për sistemin arsimor parauniversitar në Republikën e Shqipërisë” *me pjesëmarrjen e palëve*

të interesuara: Avokati i Popullit, Federata e Sindikatave të Arsimit dhe Shkencës të Shqipërisë, Sindikata e Pavarur e Arsimitarëve, Konfederata e Sindikatave të Shqipërisë, Fondacioni “Shoqëria e Hapur për Shqipërinë “ (SOROS), Shoqata “ Botuesit e Teksteve Shkollore”, Shoqata e Prindërve, Shoqata e Botuesve Shqiptarë, Shoqata “Alternativa Civile”, Shoqata “Bashkimi i Shkollave Private Shqiptare”, Fondacioni “Save the Children”, Universiteti “Aleksandër Xhuvani”, Elbasan; Universiteti “Ismail Qemali”, Vlorë; Qendra për Mbrojtjen e të Drejtave të Fëmijëve (CRCA), Koral – INC, përfaqësues të Ministrisë së Arsimit dhe Sportit, përfaqësues të Prezencës së OSBE-së në Shqipëri. Palët e interesuara kanë propozuar amendamente të cilat në pjesën më të madhe të tyre janë pasqyruar në raportin e Komisionit drejtuar seancës plenare.

2. Seancë dëgjimore (4 të tilla) për projektligjin “Për arsimin e lartë dhe kërkimin shkencor në institucionet e arsimit të lartë në Republikën e Shqipërisë” me pjesëmarrjen e palëve të interesuara: Qendra e Studimeve Albanologjike, rektorët e universiteteve publike, KALKSH, rektorët e universiteteve private, Këshilli Studentor, Forumi për Liri Akademike.; Instituti për Kritikë dhe Emancipim; Zyra për Mbrojtjen e Konsumatorit. Palët e interesuara kanë propozuar amendamente nga të cilat 9 janë pasqyruar në raportin e komisionit drejtuar seancës plenare.

3. Seancë dëgjimore për projektligjin “Për disa shtesa dhe ndryshime në ligjin nr. 10.139, datë 15.5.2009 “Për pensionet shtetërore suplementare të punonjësve të universiteteve, të shkollave të larta, Qendrës së Studimeve Albanologjike, Akademisë së Shkencave dhe të gjitha institucioneve të tjera kërkimore publike në Republikën e Shqipërisë, të cilët kanë tituj shkencorë” me pjesëmarrjen e palëve të interesuara: Federata e Sindikatave të Arsimit dhe Shkencës të Shqipërisë, Akademia e Shkencave, Qendra e Studimeve Albanologjike, pedagogë nga Universiteti European i Tiranës, pedagogë nga Albanian University, përfaqësues të Ministrisë së Mirëqenies Sociale dhe Rinisë dhe ISSH-së.

4. Seancë dëgjimore për projektligjin "Për Buxhetin e Vitit 2016", me pjesëmarrjen e palëve të interesuara: Federata e Sindikatave të Arsimit dhe Shkencës, KSSH, Sindikata e Pavarur e Arsimitarëve , Koalicioni për Arsimin e Fëmijëve të Shqipërisë, Save the Children, Fondacioni Down Syndrome Albania, Milieukontakt International Albania.


Komisioni për Edukimin dhe Mjetet e Informimin Publik gjatë vitit 2015 **ka zhvilluar 1 seancë dëgjimore për kontrollin e zbatimit të legjisllacionit:**

1. Seancë dëgjimore me përfaqësuesit e Sindikatave të Arsimit dhe përfaqësuesit Ministrisë së Arsimit dhe Sportit, lidhur me çështjen e testimit të mësuesve.


Komisionet e përhershme parlamentare dhe nënkomisionet e ngritura pranë tyre, gjatë vitit 2015, kanë zhvilluar në total 56 seanca dëgjimore publike: 47 seanca dëgjimore për procesin legjislativ dhe 9 seanca dëgjimore për kontrollin e zbatimit të legjislacionit.

Janë konsultuar gjithsej 42 projektligje. Në këto seanca dëgjimore kanë marrë pjesë 148 palë të interesuara nga të cilat 80 organizata jofitimprurëse (institute, qendra, fondacione, shoqata). Palë të tjera të interesuara kanë qenë organizata ndërkombëtare, Dhoma të Tregëtisë, subjekte private, pedagogë të universiteteve publike e private.

Paraqitja grafike e numrit të seancave dëgjimore publike të zhvilluara sipas komisioneve:



Paraqitja grafike e seanceve dëgjimore sipas llojit të tyre:



Disa të dhëna për konsultimin publik në kuadër të Reformës në Drejtësi:

Gjatë vitit 2015, për konsultimin e Analizës, Strategjisë dhe projekt amendamenteve kushtetuese janë realizuar 42 tryeza të rumbullakëta, ku kanë marrë pjesë rreth 2800 pjesëmarrës dhe kanë kontribuar 400 debatues (gjyqtarë, prokurorë, avokatë, pedagogë, përfaqësues të shoqërisë civile, etj). Janë depozituar në rrugë elektronike dhe nëpërmjet portalit të reformës 100 kontribute me shkrim për këto dokumente. Janë zhvilluar gjithashtu debate në medien audiovizive.

Në të gjitha veprimtaritë e konsultimit publik morën pjesë dhe ofruan mbështetje për procesin e reformës dhe domosdoshmërinë e saj, partnerët ndërkombëtarë të vendit tonë, Ambasadorja e Delegacionit të BE-së, Ambasadori i SHBA-ve, Ambasadori i Prezencës së OSBE-së, ambasadorë të shteteve të Bashkimit Europian, Zëvendës Sekretari i shtetit, në Byronë për Çështjet Ndërkombëtare të Zbatimit të Ligjit dhe Narkotikët, pranë Departamentit të Shtetit në Shtetet e Bashkuara të Amerikës etj.”

KAPITULLI II


1. PJESËMARRJA NË SEANCË PLENARE, VIZITA, ETJ.

Gjatë vitit 2015, Kuvendi ka përmirësuar më tej transparencën, duke vijuar punën në drejtim të rritjes së perceptimit për një parlament pranë dhe në kontakt me qytetarin si dhe përmirësimit të marrëdhënieve të tij me publikun. Në këtë kuadër, është intensifikuar puna për sjelljen e publikut në Kuvend, nëpërmjet:

- Përgatitjes dhe shpërndarjes së materialeve informuese dhe broshurave për funksionet dhe kompetencat e Kuvendit dhe organeve të tij;
- Publikimit në faqen e internetit të formularëve për ndjekjen e seancave plenare ose të mbledhjeve të komisioneve të përhershme;
- Publikimit në faqen e internetit të formularëve për të vizituar godinat e Kuvendit;
- Organizimi i Ditëve të Hapura, në orare të zgjatura, për t'i krijuar mundësinë nxënësve dhe studentëve të vizitojnë Kuvendin, në përfundim të orarit mësimor;
- Janë lehtësuar procedurat për vizitat nga grupe të organizuara nxënësish dhe studentësh.

Nga 585 vizitorë në vitin 2014, në vitin 2015 është katërfishuar numri i vizitorëve në 2187.

Paraqitja grafike e shpërndarjes së vizitorëve, gjatë muajve të vitit 2015



Sa i përket trajtesës së kërkesave drejtuar Kuvendit të Shqipërisë, evidencat dëshmojnë se shqetësimet e qytetarëve u përkasin kryesisht çështjeve që lidhen me drejtësinë, me punësimin,

shërbimin e energjisë elektrike, me kthimin dhe kompensimin e pronave, me çështjen e sigurimeve shoqërore, etj. Gjatë vitit 2015, janë shqyrtuar **633 kërkesa, ankesa, peticione**. Qytetarët kanë marrë përgjigje orientuese, informuese dhe këshillim ligjor. Kërkesat, ankesat dhe peticionet e tyre i janë përcjellë organeve të Kuvendit për trajtim të mëtejshëm. Sektori i Pritjes së Qytetarëve Këshillimit Ligjor, Trajtimit të Letrave dhe Peticioneve ka pritur në mjediset e tij **rreth 273 qytetarë, të cilët janë orientuar dhe këshilluar** lidhur me problematikat shqetësuese për ta.

Me qëllim rritjen e ndërveprimit të Kuvendit të Shqipërisë me Shoqërinë Civile, institucioni ka bashkëpunuar ngushtë me Prezencën e OSBE-së në Shqipëri duke organizuar takime informuese në kuadër të projektit “Ndërtimi i urave midis Parlamentit dhe Shoqërisë civile”, financuar nga Qeveria Gjermane.

Projekti u shtri në 6 qytete: 1 në veri (Peshkopi), 2 në Shqipërinë Qendrore (Librazhd & Durrës) dhe 3 në jug (Pogradec, Berat, Sarandë). Diskutimet u përqendruan në funksionet kryesore të Kuvendit; Organizimin e Kuvendit; Aktivitetin e Kuvendit në fushën e informimit dhe komunikimit, si dhe në Pjesëmarrjen e Grupeve të Interesit në Procesin Legjislativ. Në këto forume u zhvilluan prezantime dhe diskutime nga stafi i Kuvendit dhe po ashtu nga të ftuar të tjerë, ish-deputetë, ministra, etj.



KAPITULLI III

2. TRANSPARENCA PARLAMENTARE

Transparenca nuk është vetëm një parim themelor mbi të cilin duhet të ushtrojnë veprimtarinë e tyre institucionet shtetërore në tërësi, por mbi të gjitha është një domosdoshmëri, e cila u mundëson qytetarëve të informohen, të monitorojnë, madje të kontrollojnë veprimtarinë dhe punën e institucioneve, duke i siguruar publikut një mënyrë për t'u përfshirë në procesin e vendimmarrjes. Për këtë arsye një vëmendje e posaçme i është kushtuar nxitjes dhe forcimit të komunikimit me publikun.

Në përmbushje të objektivit të tij, për “Një Parlament, plotësisht transparent, i cili përmbush me efektivitet të lartë funksionet e tij kushtetuese të ligjvënies, kontrollit parlamentar dhe të përfaqësimit, në linjë me praktikat më të mira të funksionimit të parlamenteve evropiane”, Kuvendi i Shqipërisë ka hartuar dhe publikuar Programin e tij të Transparencës. Ky hap është hedhur në përputhje me nenin 7, të ligjit nr. 119/2014 “Për të drejtën e informimit”. Informacioni i bërë publik në këtë program, synon të bëjë transparent veprimtarinë e punës së Kuvendit të Shqipërisë, përmes paraqitjes së detajuar dhe lehtësisht të kuptueshme të informacionit që mund të aksesohet pa kërkesë për publikun në faqen zyrtare www.parlament.al, si dhe përmes prezantimit në mjediset e pritjes së publikut. Përditësimi i Programit të Transparencës për Kuvendin e Shqipërisë do të vijojë në përputhje me dispozitat e ligjit nr. 119/2014 “Për të drejtën e informimit”, nga Koordinatori për të Drejtën e Informimit. Bazuar në nenin 8 të ligjit nr. 119/2014, Kuvendi i Shqipërisë, mban dhe bën publike në faqen e internetit një regjistër të posaçëm, ku pasqyron të gjitha kërkesat për informim dhe informacionet e dhëna në përgjigje të tyre.

Në vijim të detyrimeve që rrjedhin nga neni 8 i ligjit nr. 119/2014 “Për të drejtën e informimit”, Kuvendi i Shqipërisë, mban dhe bën publik në faqen e internetit një regjistër të posaçëm, ku pasqyron të gjitha kërkesat e publikut-individëve për informim dhe informacionet e dhëna në përgjigje të tyre. Regjistri pasqyron të gjitha kërkesat për informim që i drejtohen institucionit, është i publikuar në faqen e internetit dhe përditësohet çdo 3 muaj. Identiteti i kërkuesve të informacionit nuk pasqyrohet në regjistër.

Në këtë kuadër vlen dhe një herë të vëmë në dukje publikimin e Manualit të Pjesëmarrjes së Publikut në Vendimmarrjen e Kuvendit së bashku me një përmbledhje udhëzuese të tij në faqen zyrtare të internetit www.parlament.al. Manuali është i shoqëruar me formularët e kërkesës për pjesëmarrje në punimet e Kuvendit, të publikuara dukshëm po ashtu në faqen zyrtare të internetit, www.parlament.al.

Në funksion të informimit të saktë e të paanshëm të publikut, një vëmendje e posaçme i është kushtuar dhe publikimit në kohë i projektakteve dhe akteve në faqen zyrtare në internet të Kuvendit të Shqipërisë www.parlament.al. Bazuar në Rregulloren e Kuvendit dhe në “Rregulloren për funksionimin e faqes zyrtare të Kuvendit të Shqipërisë në internet”, publikohen: teksti i projektligjeve të depozituara së bashku me relacionin shoqërues të tyre menjëherë pas njoftimit në seancë plenare; kalendari i punës së komisioneve të përhershme parlamentare menjëherë pas miratimit dhe ecuria e shqyrtimit të projektligjeve; procesverbalet e mbledhjeve të Konferencës së Kryetarëve, të komisioneve dhe të këshillave, si dhe procesverbalet e seancave plenare menjëherë pas miratimit të tyre në mbledhjen pasardhëse; teksti i amendamenteve të depozituara në komisione dhe të amendamenteve të miratuara prej tyre; raportet e komisioneve parlamentare që shqyrtojnë projektligjin; ligjet e miratuara; njoftimet për veprimtarinë parlamentare; informacione të përgjithshme: statistika, jetëshkrime, galeri videosh, galeri fotografish, struktura e administratës, njoftime për vende pune, për prokurime publike, etj.

GJETJE DHE REKOMANDIME:

I. Në lidhje me pjesëmarrjen e palëve të interesuara në seancat dëgjimore publike në komisionet e përhershme:

- Seancat dëgjimore publike janë kthyer në standard të veprimitarisë së komisioneve të përhershme, duke e shtrirë organizimin e tyre edhe për projektligjin e Buxhetit dhe projektligjeve financiare që e shoqërojnë atë;
- Seancat dëgjimore publike për procesin legjislativ kanë përparësi, krahasuar me ato për kontrollin e zbatimit të legjislacionit. Janë zhvilluar 48 seanca dëgjimore për proces legjislativ, krahasuar me 9 seanca dëgjimore për kontrollin e zbatimit të legjislacionit;
- Komisionet e përhershme kanë shfrytëzuar edhe konsultimin me shkrim të palëve të interesuara, si një mënyrë për të marrë mendimin e tyre;
- Vijon të ketë përparësi angazhimi i palëve të interesuara nëpërmjet ftesave që u bëjnë komisionet e përhershme parlamentare, krahasuar me angazhimin me shprehje interesi nga vetë palët e interesuara;
- Komisionet janë të prirura të ftojnë sa më shumë palë të interesuara duke synuar gjithëpërfshirjen e tyre, duke sjellë kështu një numër në rritje të atyre palëve që dëgjohen për herë të parë në këto seanca dëgjimore.
- Komisionet kanë qenë më të ndjeshme në dëgjimin e palëve të interesuara që përfaqësojnë shtresat vulnerabël, si gratë, fëmijët, PAK, etj.
- Komisionet e përhershme kanë vendosur ura komunikimi edhe me pedagogët e universiteteve, duke kërkuar mendimin e tyre për çështjet teknike të projektligjeve dhe duke i ftuar në seancat dëgjimore publike.

II. Në lidhje me transparencën parlamentare:

- Është përmirësuar metodologjia dhe funksionimi i instrumenteve të informimit publik lidhur me veprimtarinë parlamentare, edhe përmes teknologjisë së informacionit;
- Është rritur dukshëm ndjeshmëria dhe interesi i qytetarëve për të kërkuar informacion, në kuadër të së drejtës së informimit pranë Kuvendit të Shqipërisë;

- Është rritur interesi për të vizituar Kuvendin e Shqipërisë duke sjellë rritje të numrit të vizitorëve (katërfishuar krahasuar me një vit më parë);
- Është rritur angazhimi i shërbimeve të Kuvendit në adresimin, orientimin dhe këshillimin ligjor të qytetarëve, nëpërmjet pritjes së tyre në zyrën përkatëse.

REKOMANDIME:

- Të përmirësohet puna e koordinatorit për grupet e interesit, në drejtim të standardizimit dhe unifikimit të statistikave të shërbimit të Komisioneve për pjesëmarrjen e palëve të interesuara në seancat dëgjimore të Komisioneve, në përputhje me kërkesat e Manualit;
- Të zhvillohet profili i shërbimi i marrëdhënieve me publikun, duke krijuar mundësinë e zhvillimit të programeve të posaçme të edukimit me funksionet dhe kompetencat e Kuvendit, me qëllim informimin dhe rritjen e besimit të publikut, sidomos të të rinjve;
- Të vazhdojë të zgjerohet bashkëpunimi me Prezencën e OSBE në Shqipëri, me projekte të përbashkëta, për të shtrirë promovimin e institucionit edhe në qytetet e tjera të Shqipërisë, dhe për të shpërndarë informacionin për t'iu qasur Kuvendit, sidomos tek nxënësit dhe të rinjtë.